

DEKRET
Nr. 10973, datë 23.11.2018

PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN
NË FUQI MENJËHERË TË LIGJIT

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 88/2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1, të marrëveshjes së huas, të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në Hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013”.

Neni 2

Dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 88/2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1, marrëveshjes së huas, të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në Hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013”.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta